



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1666/3 Prot.

Tiranë, më 13 / 12 / 2018

V E N D I M

Nr. 248, Datë 13 / 12 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.182, datë 27.11.2018, të z.D. N, kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me objekt pretendimin për diskriminim “për çdo shkak tjetër”². Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues shprehet se, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë gjatë një informimi publik lidhur me aktivitetin e saj, midis të tjerash ka përhapur njoftimin dhe informacione që prekin dhe çenojnë drejtëpërdrejtë të drejtat e tij. Ai sqaron se informacioni i dhënë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë përmes një deklarate për shtyp të datës 03.03.2015 ka dëmtuar imazhin e tij, pasi që në fillim të përpilimit të saj ka shkelur haptazi parimin e prezumimit të pafajësisë, si dhe ka ekspozuar të dhënat e tij personale për një kohë prej më shumë se 3 (tre) vitesh. Ankuesi citon se përmbajtja e këtij informacioni është e pasaktë, për sa kohë rezulton që në lidhje me akuzat përkatëse është pushuar hetimi në ngarkim të tij⁴. Deklarata publike e datës 03.03.2015 e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në pikën 16 të saj citon se: “Me datë 03.03.2015, ora 16:00, në kuadër të operacionit “Chips 2015” u arrestuan në flagrancë shtetasit I.V, G.H dhe D.N. Arrestimi në flagrancë i këtyre shtetasve është bërë si “të dyshuar për kryerjen e veprave penale”. Arrestimi i tyre u krye sepse **në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë prodhuar në mënyrë të kundraligjshme patatina me mbishkrimin “Aulona”, si dhe dyshohet se kanë fallsifikuar etiketat e produkteve të pastiçerisë duke i hedhur në treg**”.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Referuar formularit të ankesës dhe dokumentacionit depozituar pranë KMD-së nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me këtë shkak.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

⁴ Referuar Vendimit të Prokurorisë pranë Gjyaktës së Shkallës së Parë Tiranë, datë 25.05.2015.

Lidhur me sa më sipër, organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sa i takon akuzave të ngritura për z.D. N ka pushuar hetimin në ngarkim të tij. Në vendimin e organit të Prokurorisë citohet se: *“...organi i hetimit del në konkluzionin se shtetasi D. N nuk rezulton të ketë bashkëpunuar me asnjërin nga të pandehurit për prodhimin e patatinave. Gjithashtu nga hetimi del se ky shtetas ka qenë fare rastësisht tek pastiçeria e të pandehurit I.V, për shkak të njohjeve që ka patur me këtë të fundit dhe për këtë arsye hetimet ndaj tij duhet të pushohen”*.

Ndërkaq, subjekti ankues, pretendimin e tij lidhur me pasaktësitë, informacionin e rremë dhe fyerjen (dëmin moral) që i është shkaktuar nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë përmes deklaratës që vijon të jetë e publikuar, e pandryshuar edhe aktualisht në faqen zyrtare të facebook-ut të këtij organi shtetëror, e ka ngritur edhe gjyqësisht.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin nr.3720, datë 22.10.2018 ka vendosur detyrimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë të realizojë veprimin administrativ për korrigjimin e deklaratës publike në lidhje me shtetasin D. N, duke saktësuar në këtë deklaratë publike se arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi në datë 03.03.2015 është bërë si “i dyshuar për kryerjen e veprave penale”.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri të shqyrtojë pretendimin e tij dhe të shprehet lidhur me ligjshmërinë e saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë parashtrim apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit, (“çdo shkak tjetër”) që të mund ta provonte atë, megjithëse i është kërkuar specifikisht nëpërmjet shkresës me nr.1666/1 prot., datë 03.12.2018 të KMD-së.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁵, çka është në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁶.

Referuar praktikës së GJEDNJ-së, ajo ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. Ky arsyetim mund të na shërbejë për analogji edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. “Çdo shkak tjetër” nuk është shkak më vehte.

Bazuar në e-mailin e datës 07.12.2018, ora 11:29 a.m dërguar nga adresa: d.n@yahoo.com, të subjektit ankues, ai ka dërguar me e-mail dokumentacion shtesë, por sërish nuk ka sjellë asnjë parashtrim apo provë për të faktuar shkakun e diskriminimit të pretenduar. Dokumentacioni bashkëlidhur konsiston në kopje të vendimeve të Prokurorisë dhe Gjykatës lidhur me sa u parashtrua më lart.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “...ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Neni 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁶ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, bazuar në dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: “Çdo shkak tjetër”